



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:087524  
Datë: 14.06.2024  
Numri i dokumentit: 05822235

**C.nr.834/21 (2021:087525)**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësve V.G.H. me nr. personal ..., M.H. me nr. personal ..., Z.H. me nr. personal ..., E.J. me nr. personal ... dhe B.Q. me nr. personal ..., të cilët me autorizim i përfaqëson avokat Rafiz Shehu nga Ferizaj, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria Rajonale në Ferizaj, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti kompensim i pagës së trembëdhjetë, shujtave ditore dhe pagës jubilarë, me lartësi të objektit të kërkesës 13.447,75€, jashtë seancës gjyqësore me datë 14.06.2024, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR** kërkesëpadia e paditësve V.G.H., M.H., Z.H., E.J. dhe B.Q. dhe **OBLIGOHET** e paditura Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë – Drejtoria Rajonale në Ferizaj, që

- -paditësit V.G.H. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2020, dhe 2021 t'ia paguaj shumën **1845.03€** (njëmijë e tetëqind e katërdhjetë e pesë euro e tre cent),
- -paditësit M.H. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2019, 2020, 2021 t'ia paguaj shumën **2576.28€** (dymijë e pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë euro e njëzetë e tetë cent),
- -paditësit Z.H. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2020 dhe 2021 t'ia paguaj shumën **1005€** (njëmijë e pesë euro)
- -paditësit E.J. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2020 dhe 2021 t'ia paguaj shumën **1005€** (njëmijë e pesë euro) dhe
- -paditësit B.Q. në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për vitet 2018, 2020 dhe 2021 t'ia paguaj shumën **1879.41€** (njëmijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë euro e katërdhjetë e një cent), të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë (datë 07.05.2021) e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e kësaj procedure kontestimore, në shumën e përgjithshme prej **685,00 €**, edhe atë për përpilimin e padisë 624,00€, për taksë gjyqësore për padi 61,00€ të gjitha këto afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

**II. REFUZOHET si e pabazuar** pjesa tjetër e kërkespadi së mbi shumat e gjykuara për paditësen V.G.H. pagën e trembëdhjetë për vitin 2019 dhe 2022 në shumën prej 1230.02€, M.H. pagën e trembëdhjetë për vitin 2022 në shumën prej 644.07€, Z.H. pagën e trembëdhjetë për vitin 2019 dhe 2022 në shumën prej 1005€, E.J. pagën e trembëdhjetë për vitin 2019 dhe 2022 në shumën prej 1005€ dhe B.Q. pagën e trembëdhjetë për vitin 2019 dhe 2022 në shumën prej 1252.94€ si dhe kërkesa e paditësve për shpenzimet procedurale lidhur me përpilimin e parashtrësës për precizim të padisë në shumën prej 624,00€.

**III. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësve V.G.H., M.H., Z.H., E.J. dhe B.Q. lidhur me kompensimin e shujtave ditore dhe pagës jubilarë, edhe atë për paditësen e parë në emër të shpenzimeve të ushqimit – shuajtjes shumën prej 1869€, shpërblimi jubilar në shumën prej 307.5€, paditësi i dytë shpërblimet e shuajtjes në shumën prej 1869€, shpërblimi jubilar në shumën prej 161.17€, paditësi i tretë shpërblimet e shuajtjes në shumën prej 1106€, paditësi i katërt shpërblimet e shuajtjes 1106€ dhe paditësi i pestë shpërblimet e shuajtjes 1869€ dhe shpërblimi jubilar prej 313.23€.

### **A r s y e t i m**

Paditësit përmes përfaqësuesit të tyre, me datën 07.05.2021, kanë paraqitur padi kundër te paditurës, me anë të cilës ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve të shuajtjes dhe pagën e trembëdhjetë dhe pagën jubilarë. Në padi kanë theksuar se paditësit, janë në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në Policinë e Kosovës, në punët dhe detyrat e Zyrtarit Policor në Ferizaj ku edhe më tutje vazhdojnë të punojnë. Paditësit që nga viti 2018 kanë vlerësim plotësisht të kënaqshëm, e po ashtu nuk ka asnjë masë disiplinore të shqiptuar ku si prove është formulari i vlerësimit të performancës, për vitin 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Më tutje kanë theksuar se paditësit i kanë plotësuar kushtet për pagën e fund vitit mbështetur në vërtetimet e lartcekura ndërsa baza juridike e kërkesëpadi së mbështetet në Udhëzimin Administrativ, nr.02/2018, Mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, e cila është në fuqi që nga data 14.11.2018, përkatësisht në kapitullin e VI Paga dhe Sistemimi i Personelit të Policisë, ku në nenin 29, paragrafi 2, parashihet se "Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit" meqenëse paditësit kanë dëshmuar se nga viti 2018, (vit i cili Udhëzimi i lartcekur është në fuqi dhe ua njeh këto të drejta), të njëjtit kanë vlerësim plotësisht të kënaqshëm dhe të njëjtit nuk kanë asnjë masë disiplinore gjatë këtyre viteve. Edhe pse paditësit i kanë plotësuar kushtet e parapara sipas Udhëzimit të lartcekur e paditura nuk ia ka kompensuar të njëjtat. Në këtë rast e paditura nuk ka respektuar Udhëzimin Administrativ, nr.02/2018, Mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës. Nga të cekurat e lartpërmendura Paditësit u detyruan që me padi ti drejtohen Gjykatës Themelore në Ferizaj me qëllim të realizimit të pagës së fund vitit. Në parashtrësën për precizimin e padisë, paditësit përmes të autorizuarit të tyre kanë hequr dorë nga kërkesa për kompensimin për shpërblim jubilar dhe shpërblimit të shuajtjes, duke mbetur vetëm pranë kërkesës për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, edhe atë për paditësen e parë në emër të pagës së 13-të për 5 vite (2018,19,20,21 dhe 22) shumën prej 3075.05€, paditësit të dytë për 5 vite si më larët shuma prej 3220,35€, paditësit të tretë në emër të pagës së 13-të për 4 vite 2019-

20-21 dhe 22 shumën prej 2010€, paditësit të katërt për 4 vite 2019-20-21 dhe 22 shumën prej 2010€ dhe paditësit të pestë pagën e 13të për 5 vite 2018-19-20-21 dhe 22 shumën prej 3132.35€, me kamatë prej 8% prej ditës së parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe i ka specifikuar shpenzimet procedurale.

E paditura nëpërmjet të autorizuarit të saj me datë 25.06.2021, ka paraqitur përgjigje në padi me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar: mbështetur në dispozitën e nenit 78 paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L-212 i punës (Mbrojtja e të drejtave për të punësuarit) 1. I punësuarit i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë të punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës. 25 3. Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh. Neni 79 Mbrojtja e të punësuarit në Gjykatë Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente. Kërkesëpadinë e paditësve sa i përket kompensimit të pagës së 13-të e ka kundërshtuar pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2021, përkatësisht ligjin nr. 05/L-125, në nenin 20 par 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017 nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë duke përfshirë edhe nenin 29 par 2 të UA. nr. 02/2018 Për marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk e ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Sa i përket kërkesëpadisë së paditësve për kompensimin e pagës së 13-të, shujtave, shpenzimet të udhëtimit për çdo vit kalendarik e kundërshtojmë pasi që kjo vlen vetëm në bazë të mundësive ligjore, financiare dhe institucionale të të paditurës dhe asnjë dispozitë ligjore nuk e parasheh si detyrim, andaj e njëjta nuk mund të jetë obligim i të paditurës e paditura ndaj paditësve të vetmin detyrim ligjor e ka përmbushjen e Kontratës së Punës e cila konsiderohet ligj për palët. Thekson se shpërblimi jubilar i është paguar paditësve dhe i ka ofruar gjykatës prova për këtë fakt. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata ka vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 398 të LPK i cili parasheh se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.” Ndërsa gjykata ka vendosur si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 399 të LPK i cili parasheh se: “399.1 Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. 399.2 Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të

cilat mbështetetë kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.” Gjykata vendosi si në pikën III. të dispozitivit të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 149 të LPK i cili parasheh se: “149.1 Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë”

Gjykata pas analizimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, konstaton se në tyre është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë. Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit të paditësve, i cili është i bashkangjitur në shkresa të lëndës për secilin paditës. Nga vërtetimi i punësimit i datës 23.04.2021, të lëshuar nga MPB– Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, gjykata ka vërtetuar se paditësja V.G.H. është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 27.03.2000, dhe paga e fundit e saj ka qenë 615.01€, për një muaj kalendarik. Nga vërtetimi i punësimit i datës 22.04.2021, të lëshuar nga MPB– Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, gjykata ka vërtetuar se paditësi M.H. është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 12.01.2004, dhe paga e fundit të tij ka qenë 644.07€, për një muaj kalendarik. Nga vërtetimi i punësimit i datës 16.04.2021, të lëshuar nga MPB– Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, gjykata ka vërtetuar se paditësi Z.H. është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 11.11.2019, dhe paga e fundit të tij ka qenë 502.50€, për një muaj kalendarik. Nga vërtetimi i punësimit i datës 16.04.2021, të lëshuar nga MPB– Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, gjykata ka vërtetuar se paditësi E.J. është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 11.11.2019, dhe paga e fundit të tij ka qenë 502.50€, për një muaj kalendarik. Nga vërtetimi i punësimit i datës 16.04.2021, të lëshuar nga MPB– Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, gjykata ka vërtetuar se paditësi B.Q. është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data e 24.04.2000, dhe paga e fundit të tij ka qenë 626.47€, për një muaj kalendarik.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-076, për Policinë, si dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 213/2023 të datës 09.10.2023. Në nenin 55 par. 1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 ku përcaktohet se: “i punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”. Në nenin 44 par. 2 të Ligjit nr. 04/L-076, për Policinë, përcaktohet se: “marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”. Ndërsa neni 55 par. 1 nën par. 1.7 i këtij Ligji përcakton se: “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2 të nenit 44 të këtij ligji”. Në nenin 5 par. 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 i datës 14.11.2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, përcaktohet se: “në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”, ndërsa në pikën 1 të këtij paragrafi parashihet “zyrtarët policor që bëjnë betimin dhe të

cilët kanë autoritet t'i ushtrojnë autorizimet dhe detyrat policore". Ndërkaq në nenin 29 par. 2 të këtij udhëzuesi është paraparë se "personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit". Pastaj, sipas pikës II. të mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 213/2023 të datës 09.10.2023, parashihet se në kontestet nga marrëdhënia e punës- lidhur me kërkesat për shpërblimin e pagës së 13-të, për personelin e policisë, që janë paraqitur pas datës 14.11.2018, në bazë të nenit 29 par. 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018 dhe në bazë të nenit 30 par. 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021 mbi Marrëdhëniet e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Andaj gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar pasi që gjykata vlerëson se paditësit e gëzojnë të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik, ta përfitojnë si shpërblim, një page mujore, e cila pagë do të jetë e njëjtë me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësit, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës dhe nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve në rastin konkret për paditësit, gjykata mori për bazë vërtetimin e punësimit të lëshuar nga e paditura, e nga e cila rezulton paga të cilën e realizojnë paditësit dhe përvojën e punës tek e paditura, andaj paditësit ju njoh e drejta në kompensim ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit, që gjenden ne shkresat e lëndës, konstatohet se paditësit, kanë vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtëve nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, përgjatë viteve të kërkuara me kërkesëpadi. Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se "shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të". Andaj, meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësve për vitet e kaluara, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj paditësve. Ashtu që, gjykata vlerëson se paditësit kanë të drejtë që të kërkojnë pagën e trembështjetë, duke u mbështetur edhe në dispozitat nën – ligjore respektivisht Udhëzimin Administrativ të cekur më lartë i cili në mënyrë të qartë e përcakton të drejtën e paditësve për të marrë pagat të përshkruara në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata, vlerëson se e paditura ka detyrim sipas dispozitave të lartpërmendura, që t'i kompenzoj paditësit pagat e trembëdhjeta duke u bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura ju ka mbetur borxh paditëses me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompenzoj shumat e gjykata si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 par 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme për kamatat të datës 02.12.2020.

Gjykata e ka refuzuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë për kompensimin e pagës së trembëdhjetë për vitin 2022 pasi që Udhëzimi Administrativ nr.01/2021 i cili ka hyrë në fuqi me datë 29.09.2021 e ka shfuqizuar Udhëzimin Administrativ nr. 02/2018 i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018 e që i bie se personeli i policisë ka të drejtë edhe për një pagë ekuivalente me pagën e rregullt mujore, që nga kjo i bie që për vitin 2022 paditësve nuk iu takon paga e trembëdhjetë, e po ashtu e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë për paditësen V.G.H. pagën e trembëdhjetë për vitin 2019 dhe 2022 në shumën prej 1230.02€, M.H. pagën e trembëdhjetë për vitin 2022 në shumën prej 644.07€, Z.H. pagën e trembëdhjetë për vitin 2019 dhe 2022 në shumën prej 1005€, E.J. pagën e trembëdhjetë për vitin 2019 dhe 2022 në shumën prej 1005€ dhe B.Q. pagën e trembëdhjetë për vitin 2019 dhe 2022 në shumën prej 1252.94€ për shkak se paditësit nuk kanë ofruar prova lidhur me vlerësimet e performancës së tyre për këto vite të kërkuara me kërkesëpadi.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuar nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësve duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura, përderisa e paditura me asnjë provë shkresore – analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit, për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësve t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 725,00 €, edhe atë për përpilimin e padisë 624,00€, për taksë gjyqësore për padi 101,00€ të gjitha këto afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nen kërcënimit e përmbartimit të dhunshëm, konform TOAK ndërsa kërkesa për shpenzimet procedurale lidhur me përpilimin e parashtrësës për precizim të padisë në shumën prej 624,00€ refuzohet si e pabazuar për shkak se kjo parashtrësë nuk hyn në grupin e parashtrësave për të cilat duhet paguar kompensimi.

Gjykata vendosi si në pikën III. të këtij aktgjykimi lidhur me kërkesën për shujta ditore dhe shpërbllim jubilar duke i refuzuar si të pabazuar këto kërkesa sepse i autorizuari i paditësve sipas parashtrësës për precizim të kërkesëpadisë të dt. 24.11.2023 ka hequr dorë shprehimisht nga kërkesëpadija e paditësve sa i përket pagës jubilarë dhe shuajtjes ndërsa ka mbetur vetëm në kërkesën për pagën e 13-të.

Nga të gjitha të lartëcekurat, gjykata konform nenit 143 të LPK vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**Datë 14.06.2024**

**Gjyqtari**

**Armend Ahmeti**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.